

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për krime të rënda - në trupin gjykues në përbërje të gjyqtarit Vehbi Kashtanjeva - kryetar i trupit gjykues, me pjesëmarrjen e procesmbajtjes Ferinaze Jashari, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.B., për shkak të veprës penale Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I.nr.391/2015, të datës 17.03.2016 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë verbal e publik në prezencë të prokurores së shtetit Besa Limani, të akuzuarit H.B., me datë 29.03.2017 publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

H.B., i biri i A., dhe nënës H., e gjinis I., i lindur me datën *data e lindjes...*, me vendbanim në F. K., rruga ‘...’, kompleksi i banesave kati i ...’, afër Xhamisë në F.K., punon si pastrues privat, i martuar, baba i një femiu, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal *numër personal...*

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 08.06.2014, gjatë mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë, i pandehuri ka votuar me kusht në qendrën e votimit me numër 0901E/12D, në shkollën fillore ‘S. R.’, në F. K., edhe pse e ka shfrytëzuar të drejtën dhe ka votuar i rregullt në qendrën e votimit me numër 0324E/01D, në shkollën fillore në fshatin V., Komuna e G..

-më këtë ka kryer veprën penale Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së,

Andaj, gjykata në bazë të neneve: 2,4,41,42, 49,50,51,52,73, të KPRK-së dhe nenit 365, 368 nenit 450 të KPPK-së, e:

GJYKON

MË DËNIM ME BURGIM-DËNIM ME KUSHT në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari H.B. në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30 (tridhjetë) euro**, në afat prej **15 ditësh** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.391/2015, të datës 17.03.2016 kundër të akuzuarit H.B. për shkak të veprës penale Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 nënpar.1.2 të KPK-së. Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestarë me datën 29.03.2017, në të cilën prokurorja e shtetit Besa Limani, ka bërë lëxim të atakuzës dhe pasi që i akuzuari H.B., është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPRK-së, i njëjti ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk ka nevojë për sqarim shtesë dhe pasi që i ipet mundësia që të pranoj, ose mos e pranoj fajësinë lidhur me veprën penale që i vihet në barrë, i akuzuari H.B., në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, deklaroi se e pranonte fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza e prokurorisë.

Prokurorja e shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë dhe vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kushtet nga neni 248 par.1 i KPPRK-së, se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare i cili pranim mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialin e prezantuar nga prokurorja e shtetit, të pranuar nga i akuzuari. Duke marr parasysh se pranimi i fajësisë është arritur në shqyrtimin fillestarë konform nenit 248 par.4 të KPPK-së.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe pasi që bindet se janë vërtetuar faktet lidhur me pranimin e fajësisë vazhdoi me shqiptimin e dënimit duke marr parasysh se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje direkte, ka qenë i vetëdijshëm për veprën e veta dhe e ka dashur kryerjen e saj.

Me rastin e përcaktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat letësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit mori parasysh pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë, sinqeritetin e tij deklarues që për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin. Për të akuzuarin gjykata nuk gjeti rrethana rëndësuese.

Gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe me aplikimin e dispozitave ligjore të përmendura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe i njëjti do të shërbejë si preventivë individuale dhe gjenerale dhe parandalim se në të ardhmen nuk do të kryen vepra tjera penale, duke ndikuar në rehabilitimin e tij.

Gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit siç është paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 nën.par.2.6 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**-GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.147/16, të dates 29.03.2017**

Procesmbajtësja:

Ferinaze Jashari

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari:

Vehbi Kashtanjeva

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.